



DFJC - Département de la formation, de la jeunesse et de la culture
DGEO - Direction générale de l'enseignement obligatoire

Paraqitje e Ciklit 3

Informim për prindërit

**Shkalla e dytë
(Arsimi i mesëm i ulët)**

Vitet 9S dhe 10S

Botimi 2018-2019

Shkolla e detyrueshme shtrihet në njëmbëdhjetë vjet. Ajo synon që nxënësi të marrë dijeni dhe kompetenca, të zhvillojë dhe të ushtrojë aftësitë e veta intelektuale, krijuese, fizike e në punë dore, dhe të formojë gjykimin dhe personalitetin e vet. Shkolla i lejon nxënësit të përfshihet në jetën shoqërore, profesionale dhe qytetare përmes njohjes së vetvetes dhe të botës që e rrethon, si dhe përmes respektimit të të tjerëve.

Kjo fletëpalosje paraqet ciklin 3 dhe në veçanti vitin e 9-të e dhe vitin e 10-të të shkallës së dytë I (arsimit të mesëm të ulët). Ajo përshkruan pikërisht dispozitivin e drejtimeve dhe të niveleve të parashikuara nga ligji për arsimin e detyrueshëm (LEO). Ky dokument paraqet, sipas një logjike kronologjike, kushtet e kalimit dhe të riorientimit në drejtime.

Cikli 3, që zgjat tre vjet, mbyllet me një certifikatë të përfundimit të studimeve të shkallës së dytë që shënon mbarimin e shkollimit të detyrueshëm. Në përfundim të vitit të 11-të, riorientime të ndryshme janë të mundshme.

www.vd.ch/solarite

Burimet: Loi sur l'enseignement obligatoire (LEO)
Règlement d'application de la LEO (RLEO)
Cadre général de l'évaluation (CGE)

Janë të besueshëm vetëm kuadri ligjor e rregullues dhe Kuadri i përgjithshëm i vlerësimit (CGE), i cili trajton në mënyrë të tërësishme rastet e ndryshme.

Organizimi dhe tabela e orarit

Shkalla e dytë I përmban dy drejtime: drejtimin parajimnazial (*voie pré-gymnasiale*, VP) dhe drejtimin e përgjithshëm (*voie générale*, VG).

Në ciklin 3, nxënësi ndjek mësimet sipas objektivave të përcaktuara nga Plani romand i studimeve (*Plan d'études romand*, PER) dhe programet kantonale. Tabela e orarit përmban 33 periudha në javë për nxënësit e vitit të 9-të dhe 32 për ata të vitit të 10-të e të 11-të (2018-2019, 33 periudha në vitin e 9-të e atë të 10-të dhe 32 në vitin e 11-të; prej 2019-2020, 33 periudha nga viti i 9-të në vitin e 11-të). Metodatat e punës, strategjitë e të nxënies, aftësia për të bashkëpunuar dhe për të komunikuar zhvillohen në dhënien e të gjitha lëndëve.

Vlerësimi

Vlerësimi i punës të nxëniesit komunikohet në agjendë në formën e notave që shkojnë nga 1 deri në 6 me gjysmë-pika (TS dhe TA). Nota 4 përkon me pragun e mjaftueshmërisë. Nota më e lartë është 6-ta, nota më e ulët 1-shi.

Mesataret e mara nga nxënësi organizohen sipas grupeve të lëndëve dhe vendimet lidhur me rrugëtimin e nxëniesit bazohen në shumën e pikave të mara në secilin prej grupeve.

Në mbarim të semestrit dhe të vitit shkollor, jepet një vlerësim i gjendjes. Ai përmban një listë të notave dhe të mungesave, si dhe mesataret sipas lëndëve të përcaktuara me gjysmë-pikën më të afërt. Në fund të vitit shkollor dhe në rast ndryshimi të drejtimin apo të nivelin në mbarim të semestrit të 1-rë, një buletin përmban mesataret dhe tregon vendimin lidhur me rrugëtimin e nxëniesit. Ky buletin i bashkëngjitet librezës shkollore.

Në fund të vitit të 10-të, nxënësi kalon provimet kantonale të referencës (*Epreuve cantonale de référence*, ECR) në frëngjisht dhe në matematikë. Nota e çdo provimi merret parasysht gjatë përlllogaritjes të mesatares vjetore të lëndës përkatëse, në të njëjtën mënyrë si një punë domethënëse (TS).

Drejtimi parajimnazial (VP)

Drejtimi parajimnazial pret nxënësit që do të mund të hyjnë drejtpërdrejt në studimet e maturës gjimnaziale nëse marrin çertifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë.

Nxënësit përzgjedhin një lëndë me zgjedhje specifike (*option spécifique*, OS) ndërmjet lëndëve të mëposhtme: ekonomi e drejtësi, italisht, latinisht apo matematikë e fizikë.

Plani romand i studimeve (PER)

www.plandetudes.ch

PER-ja përcakton përmbajtjen e mësimave të shkollimit të detyrueshëm për Zvicrën romande. Ai përshkruan atë që nxënësit duhet të mësojnë gjatë njëmbëdhjetë vjetëve të shkollimit.

Punët domethënëse (*travaux significatifs*, TS)

rregullisht dhe përgjatë tërë vitit, vlerësimi i punës shkollore të nxëniesit bëhet me ndihmën e punëve domethënëse. Ato përbëjnë elementet thelbësore të vlerësimit. Çdo punë domethënëse synon të paktën një objektiv mësimor të përcaktuar nga Plani romand i studimeve (PER) me një apo disa prej përbërësve të tij që kanë qenë objekt i një mësimdhënieje.

Punët e përvetësuara (*travaux assimilés*, TA)

një sërë punësh që verifikojnë vetëm përvetësimin e njohurive apo të teknikave specifike. Kjo tërësi punësh është objekt i një note për çdo lëndë. Për çdo lëndë, numri i këtyre punëve të përvetësuara nuk mund të kalojë një të katërtën e tërësisë së punëve të caktuara.

Viti i 9-të dhe ai i 11-të: 33 per./Viti i 11-të : 32 per.	
Lëndët në tabelën e orarit (VG)	Frëngjisht
	Gjermanisht
	Anglisht
	Matematikë
	Shkencat e natyrës
	Histori - Etikë dhe kulturë fetare
	Gjeografi - Qytetari
	Artet vizuale
	Muzikë
	Veprimtari krijuese dhe punë dore
	Edukimi fizik
	Lëndë me zgjedhje specifike (OS)

Mediat, figurat dhe teknologjitë e informimit dhe komunikimit (MITIC)

Drejtimi i përgjithshëm (VG)

Drejtimi i përgjithshëm pret nxënësit që destinohen kryesisht për formimin profesional (të nxënësve të një zanati), si dhe për në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose maturës profesionale.


Në drejtimin e përgjithshëm, dy nivele parashikohen për frëngjisht, për matematikë dhe për gjermanisht. Niveli 1 përkon me kërkesa bazë, ndërsa niveli 2 përkon me kërkesa më të larta. Nxënësi mund të ndodhet kështu në nivele të ndryshme në këto tri lëndë, gjë që lejon përshtatjen e mësimdhënies sipas aftësive të tij.

Nxënësi ndjek lëndë me zgjedhje të kompetencave të orientuara drejt zanateve (OCOM): 2 periudha për grupin Formim i përgjithshëm jepen për tërë klasën; sa i përket 2 periudhave të tjera; nxënësi përzgjedh një lëndë me zgjedhje artizanale, artistike, tregtare ose (AACT) teknologjike. Ndër OCOM-të, vetëm lënda me zgjedhje AACT është objekt vlerësimi. Mesatarja e saj merret parasysh njëllor si lëndët e tjera në llogarinë e pikave të grupit I.

Sipas projektit të tij të formimit dhe me disa kushte, nxënësi ka mundësi t'i zëvendësojë OCOM-të me një lëndë me zgjedhje specifike (OS) - ekonomi e drejtësi, italisht, latinisht ose matematikë e fizikë - dhe/ose të ndjekë një arsimim të drejtimit parajimnazial për frëngjisht, për matematikë, për gjermanisht ose për anglisht.

Rorientimi nga një drejtim në tjetrin mund të ndodhë në fund të semestrit të 1-rë të vitit të 9-të dhe në fund të vitit të 9-të dhe të vitit të 10-të. Kalimi nga një drejtim në tjetrin mund të ndodhë në fund të çdo semestri, nga fundi i semestrit të 1-rë të vitit të 9-të deri në fund të semestrit të 1-rë të vitit të 11-të. Ndryshimet e drejtimit dhe të nivelit bëhen në bazë të rezultateve shkollore. Vendimet e riorientimit merren prej këshillit drejtues, pasi dëgjohen nxënësi dhe prindërit e tij.

Nxënësve që ndjekin një arsimim të nivelit 1 njëkohësisht për frëngjisht, për matematikë dhe për gjermanisht përfitojnë nga një mbështetje e veçantë në këto tri lëndë (arsim i përforcuar). Këshilli drejtues i entit shkollor vendos për format e kësaj mbështetjeje:



¹ Veprimtari krijuese dhe punë dore

² Lëndët me zgjedhje të kompetencave të orientuara drejt zanateve

Mediat, figurat dhe teknologjia e informimit dhe komunikimit (MITIC)

Kurse fakultative për greqisht dhe italisht (viti i 10-të dhe i 11-të)

Në vitin e 10-të e të 11-të, një kurs fakultativ për greqisht u ofrohet nxënësve të drejtimit parajimnazial që dëshirojnë të marrin njohuritë e para në këtë gjuhë dhe të bëhen të ndjeshëm për kulturën e saj.

Në vitin e 11-të, një kurs për italisht u ofrohet nxënësve të drejtimit të përgjithshëm që dëshirojnë të hyjnë në klasat e rakordimit 2 me italishten si lëndë me zgjedhje specifike. Ky kurs u ofrohet edhe nxënësve të tjerë të klasës 11, të drejtimit të përgjithshëm ashtu si edhe të drejtimit parajimnazial, që dëshirojnë të mësojnë këtë gjuhë.

Këto dy lëndë janë objekt i një vlerësimi që u komunikohet nxënësve dhe prindërve. Sidoqoftë, rezultatet e këtij vlerësimi nuk mbahen parasysh në vendimet e kalimit, riorientimit apo çertifikimit.


Lëndët me zgjedhje të kompetencave të orientuara nga zanatet (options de compétences orientées métiers, OCOM) e drejtimit të përgjithshëm

Një fletëpalosje shpjeguese lidhur me OCOM-të gjendet në sitin tonë të Internetit:

www.vd.ch/scolarité > Parent information and translated documents - Documents traduits d'information aux parents.

Rrugëtimi në drejtimet e shkallës së dytë (arsimit të mesëm të ulët)

Kalimi dhe mundësitë e riorientimit nga një drejtim apo nivel në tjetrin



Çertifikimi në fund të vitit të 11-të

Një fletëpalosje që paraqet kushtet e çertifikimit të nxënësve të vitit të 11-të dhe kushtet e hyrjes në klasat e rakordimit, në klasat plotësuese, si dhe në formimet pas arsimit të detyrueshëm gjendet në sitin tonë të Internetit: www.vd.ch/scolarite > Parent information and translated documents - Documents traduits d'information aux parents.

Klasat e rakordimit

Një fletëpalosje shpjeguese lidhur me klasat e rakordimit gjendet në sitin tonë të Internetit: www.vd.ch/scolarite > Parent information and translated documents - Documents traduits d'information aux parents.

Rrugëtimi në drejtimin parajimnazial (VP)

A Fundi i semestrit të 1-rë

Kushtet e riorientimit në drejtimin e përgjithshëm (viti i 9-të)

VP → VG në disa raste, nxënësi-ja i/e drejtimit parajimnazial mund të riorientohet në drejtimin e përgjithshëm. Kjo ndodh kur prindërit bëjnë kërkesë ose me mendimin paraprak të këshillit të klasës: Vendimi përfundimtar i takon këshillit drejtues. Ky ndryshim drejtimi në fund të semestrit të 1-rë është i mundur vetëm në vitin e 9-të.

B D Fundi i viti shkollor

Kushtet e kalimit (viti i 9-të dhe i 10-të)

Për të kaluar, nxënësi duhet të marrë të gjitha pikat vijuese për grupet I, II dhe III:

Grupi I	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + shkencat e natyrës + lëndë me zgjedhje specifike	20 pika e sipër
Grupi II	anglisht + gjeografi + histori - etikë dhe kulturë fetare	12 pika e sipër
Grupi III	artet vizuale + muzikë + veprimtari krijuese dhe punë dore	12 pika e sipër ¹
Rastet limite	<i>e shumta 1 pikë pamjaftueshmëri e mbledhur në të 3 grupet dhe e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në një grup.</i>	

¹ Në vitin e 10-të, lëndët përkatëse janë artet vizuale dhe muzika dhe pragu është caktuar në 8 pika.

Përsëritja (nga viti i 9-të deri në të 11-tin)

Në parim, nxënësi që nuk i përmbush kushtet e kalimit përsërit vitin në drejtimin parajimnazial.

Riorientimi në drejtimin e përgjithshëm (viti i 9-të dhe ai i 10-të)

Në disa raste, nxënësi mbetës mund të riorientohet në drejtimin e përgjithshëm pa përsëritje. Kështu ndodh kur nxënësi tashmë e ka përsëritur një herë vitin shkollor në vazhdim, kur ai e ka përsëritur dy herë vitin gjatë shkollimit të tij apo edhe kur prindërit bëjnë kërkesë ose me mendimin paraprak të këshillit të klasës. Në rast riorientimi në drejtimin e përgjithshëm, në parim nxënësi përfshihet në nivelin 2 në tri lëndët me nivel.

Në mënyrë të përgjithshme, **rastet limite** kanë të bëjnë me gjendjet në të cilat rezultatet e nxënësit-ës përkatës-e janë shumë pak më të ulëta nga ato që kërkohen për të plotësuar kushtet e kalimit, e riorientimit nga një drejtim në tjetrin apo të çertifikimit. Nocioni i rasteve limite nuk zbatohet për vendimet e kalimit nga një nivel në tjetrin. Këshilli drejtues vendos kryesisht për rastet limite.

Këshilli drejtues çmon, me kërkesën e prindërve, **rrethanat e veçanta** të mundshme (për shembull një shkollim i trazuar rëndë e për një kohë të gjatë nga një sëmundje e zgjatur, nga mbërritja rishtazi nga një kanton tjetër apo nga jashtë vendit). Që një rrethanë e veçantë të merret parasysh, duhet që një sukses i mëvonshëm të gjykohej i mundshëm.

Rrugëtimi në drejtimin e përgjithshëm (VG)

(A) (C) (E) Fundi i semestrit të 1-rë

Kushtet e kalimit nga një nivel në tjetrin (nga viti i 9-të në të 11-tin)

- N1 → N2** Kalimi nga niveli 1 në nivelin 2 është i mundur për nxënësin që arrin në një lëndë me nivel një mesatare semestriale prej:
- 5,5 e sipër;
 - 5, me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës.
- N2 → N1** Me kërkesën e prindërve ose me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës, nxënësi mund të kalojë nga niveli 2 në nivelin 1.

Kushtet e riorientimit në drejtimin parajimnazial (viti i 9-të)

- VG → VP** Vetëm në vitin e 9-të, nxënësi-ja mund të riorientohet në drejtimin parajimnazial nëse ai/ajo i ndjek tri lëndët me nivel në nivelin 2, si dhe një lëndë me zgjedhje specifike, dhe nëse i merr të gjitha pikat vijuese për grupet I dhe II:

Grupi I	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + shkencat e natyrës + lëndë me zgjedhje specifike	24 pika e sipër
Grupi II	anglisht + gjeografi + histori - etikë dhe kulturë fetare	13,5 pika e sipër
Rastet limite	<i>e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në njerin prej dy grupeve.</i>	

Në rast ndryshimi të nivelit apo riorientimi në përfundim të semestrit, merren parasysh vetëm rezultatet e semestrit të dytë në përlllogaritjen e mesatares vjetore të lëndëve përkatëse.

(B) (D) Fundi i vitit shkollor

Kushtet e kalimit (viti i 9-të dhe ai i 10-të)

Për të kaluar, nxënësi duhet të marrë të gjitha pikat vijuese për grupet I, II dhe III, cilatdo qofshin nivelet e ndjekura në frëngjisht, në matematikë dhe në gjermanisht:

Grupi I	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + shkencat e natyrës + lënda me zgjedhje artizanale, artistike, tregtare apo teknologjike (ose OS)	20 pika e sipër.
Grupi II	anglisht + gjeografi + histori - etikë dhe kulturë fetare	12 pika e sipër
Grupi III	artet vizuale + muzikë + veprimtari krijuese dhe punë dore / edukim i të ushqyerit	12 pika e sipër
Rastet limite	<i>e shumta 1,5 pikë pamjaftueshmëri e mbledhur në të tri grupet dhe e shumta 1 pikë pamjaftueshmëri në një grup.</i>	

Vendimet e kalimit, riorientimit dhe kalimit nga një nivel në tjetrin mund të bëhen objekt i një **ankimi** pranë Departamentit: *Instruction des Recours, Département de la formation, de la jeunesse et de la culture, rue de la Barre 8, 1014 Lausanne*. Ankimi i motivuar bëhet me shkrim brenda një afati 10-ditor nga njoftimi i tij, me një kopje të vendimit të kundërshtuar.

Kushtet e kalimit nga një nivel në tjetrin (viti i 9-të dhe i 10-të)

- N1 → N2** Kalimi nga niveli 1 në nivelin 2 është i mundur për nxënësin që arrin në një lëndë me nivel një mesatare semestriale prej:
- 5,5 e sipër;
 - 5, me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës.
- N2 → N1** Nxënësi kalon nga niveli 2 në nivelin 1 nëse në lëndën përkatëse merr një mesatare vjetore prej:
- 3, apo më pak;
 - 3,5, me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës.

Kushtet e riorientimit në drejtimin paragjimnazial (viti i 9-të dhe ai i 10-të)

VG → VP me përsëritje

Nxënësi-ja mund të riorientohet në drejtimin paragjimnazial me përsëritje nëse ai/ajo ka ndjekur tri lëndë me nivel në nivelin 2, si dhe lëndë me zgjedhje të kompetencave të orientuara drejt zanateve, dhe nëse i ka marë të gjitha pikat vijuese për grupet I dhe II:

Grupi I	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + shkencat e natyrës	20 pika e sipër
Grupi II	anglisht + gjeografi + histori - etikë dhe kulturë fetare	13,5 pika e sipër
Rastet limite	<i>e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në njerin prej dy grupeve.</i>	

VG → VP pa përsëritje

Nxënësi-ja mund të riorientohet në drejtimin paragjimnazial, në parim pa përsëritje, nëse ai/ajo ka ndjekur tri lëndë me nivel në nivelin 2, si dhe një lëndë me zgjedhje specifike, dhe nëse i ka marë të gjitha pikat vijuese për grupet I dhe II:

Grupi I	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + shkencat e natyrës + lëndë me zgjedhje specifike	24 pika e sipër
Grupi II	anglisht + gjeografi + histori - etikë dhe kulturë fetare	13,5 pika e sipër
Rastet limite	<i>e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në njerin prej dy grupeve.</i>	

Përsëritja (nga viti i 9-të në të 11-tin)

Nxënësi që nuk i përmbush kushtet e kalimit përsërit vitin në drejtimin e përgjithshëm. Ai ndryshon nivel në rastet e mëposhtme.

- N1 → N2** Nxënësi kalon nga niveli 1 në nivelin 2 nëse në lëndën përkatëse merr një mesatare vjetore prej:
- 5 e sipër;
 - 4,5, me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës.
- N2 → N1** Nxënësi kalon nga niveli 2 në nivelin 1 nëse në lëndën përkatëse merrnjë mesatare vjetore prej:
- 3, apo më pak;
 - 3,5, me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës.

Marrëdhënia shkollë-familje

Shkolla siguron kryesisht arsimimin e fëmijëve dhe ua njeh prindërve përparësinë në fushën edukimit. Megjithatë, këto misione nuk janë përjashtuese, meqenëse bashkëpunimi i familjeve kërkohet në fushën e arsimimit dhe shkolla ndihmon familjet në fushën e edukimit.

Mësuesi-ja kujdestar-e i-e klasës, si dhe drejtorja e entit shkollor janë bashkëbiseduesit e privilegjuar të prindërve për sa i përket shkollimit të fëmijës së tyre, për faktin e marrëdhënies të afërsisë të tyre me gjendjen e tij.

Prindërit informohen rregullisht me nxëniet shkollore dhe vlerësimin që rrjedh prej tyre. Ata dëgjohen para çdo vendimi të rëndësishëm që ka të bëjë me rrugëtimin shkollor të fëmijës së tyre. Vendimet përfundimtare i takojnë këshillit drejtues.

Të paktën një herë në vit, në parim në fillim të viti shkollor, organizohet një seancë informuese për prindërit. Kjo bën të mundur ndër të tjera shpjegimin e zhvillimit të shkollimit, objektivave të planit mësimor dhe kushteve të vlerësimit.

Informacionet e shkollës komunikohen rregullisht përmes agjendës të nxënësit të cilën prindërit e nënshkruajnë në fund të çdo jave. Është pikërisht përmes kësaj që prindërit dhe mësuesit-et mund të kërkojnë një takim. Këto shkëmbime, që mund të bëhen në çdo moment të vitit shkollor, sigurojnë një bashkëpunim të mirë.

Masa pedagogjike plotësuese mund të merren kur kjo është e nevojshme për të siguruar përparimin e nxënësit. Shërbime të tjera mund të jepen nga psikologët, psikomotricienët, apo logopedistët në mjedisin shkollor (PPLS), në përputhje me procedurat e vendosura në entin shkollor sipas specifikave të veta.

Informacione pikërisht lidhur me pritjen parashkollore apo me shërbimet e tjera mund të merren pranë drejtorisë së entit shkollor.

		Rac 1 dhe Rac 2 klasat e mësimit plotësues		shkalla e dytë I (arsimi i mesëm i ulët)
14 - 15 vjeç	11S	cikli i tretë drejtimi i përgjithshëm	cikli i tretë drejtimi paragjimnazial	
13 - 14 vjeç	10S			
12 - 13 vjeç	9S			
11 - 12 vjeç	8P	cikli i dytë fillor		shkalla e parë (arsimi fillor)
10 - 11 vjeç	7P			
9 - 10 vjeç	6P			
8 - 9 vjeç	5P			
7 - 8 vjeç	4P	cikli i parë fillor (përfshirë shkollën foshnjore)		shkalla e parë (arsimi fillor)
6 - 7 vjeç	3P			
5 - 6 vjeç	2P			
4 - 5 vjeç	1P			

Struktura e shkollës të detyrueshme vaudeze



www.vd.ch/scolarite



www.vd.ch/page/1055372